



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 7284 Prot
Shkodër, me 10.05.2021



TERRE DES HOMMES
MISIONI NË SHQIPËRI

Nr. 32 Prot
Shkodër, me 10.05.2021

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ("Marrëveshja"), nënshkruhet sot me datë 10/05/2021, nga dhe ndërmjet palëve të mëposhtme:

BASHKIA SHKODËR, me adresë: Rr. "13 Dhjetori", Nr. 1, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër **Znj. Voltana Ademi**, këtej e tutje e cilësuar si **Bashkia**;

dhe

TERRE DES HOMMES, MISIONI NË SHQIPËRI, një fondacion zvicerian me qendër në Lozanë, punon për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa dallim feje, rrace, gjinie apo përkatësie politike, rregjistruar në Gjykatën e Tiranës Shqipëri në vitin 2005, identifikuar me NIPT K62106002A, me adresë: Rruga Skënderbeg 21/1, Tiranë, përfaqësuar nga drejtore **Znj. Enkelejda Kallëciu**, këtej e tutje e quajtur "**Tdh**".

NENI 1

Objekti

Objekti i kësaj Marrëveshje është rregullimi i bashkëpunimit ndërmjet palëve, me qëllim zhvillimin dhe aksesin në shërbime cilësore të mbrojtjes së fëmijës, në shërbime me bazë komunitare të fokusuara në fuqizimin edhe përfshirjen sociale të familjeve, të rinjve dhe fëmijëve



vulnerabël në rrezik për migrim të pasigurtë dhe në rrezik trafikimi, mbështetja dhe integrimi i fëmijëve në konflikt me ligjin, promovimin e të drejtave dhe mirëqënies së tyre. Një fokus të veçantë në bashkëpunim për vitin 2021 do të ketë përgjigja direkte ndaj situatave të emergjencave si dhe zbatimi i programeve për ngritje të kapaciteteve për profesionistët e fushës.

NENI 2

Baza Ligjore

Kjo Marrëveshje lidhet në përputhje me Ligjin nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, tw ndryshuar, Ligjin nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurese” i ndryshuar, Ligjin nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e fëmijës”, Ligjin Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin Nr 911, dt 28.12.2018 “Për miratimin e standarteve të shërbimeve të qendrave komunitare shumëdisiplinore”, dhe çdo ligj tjetër të Republikës së Shqipërisë të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që prek drejtpërdrejt apo jo këtë marrëveshje bashkëpunimi.

NENI 3

Parimet e bashkëpunimit

Nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, palët sigurojnë se gjatë veprimtarisë së tyre do të udhëhiqen nga parimi i ligjshmërisë, mosdiskriminimit, respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me synim koordinimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor, si dhe atë të kujdesit shoqëror.

NENI 4

Objektivat specifike të kësaj marrëveshje

1. Përmirësimi i aksesit në shërbime komunitare, sociale dhe edukative, i fëmijëve dhe familjeve vulnerabël të rikthyer apo në rrezik për migrim të pasigurtë dhe rintegrimi i tyre në shoqëri, si dhe fëmijëve dhe familjeve vulnerabël në rrezik trafikimi.



2. Zhvillimi i mëtejshëm i shërbimeve komunitare me në fokus fëmijët dhe aksesin në shërbime cilësore për fëmijët dhe familjet vulnerabël apo në rrezik.
3. Fuqizimi afatgjatë ekonomik i të rikthyerve në nevojë, përmes mundësive konkrete të punësimit, vetë-punësimit dhe zhvillimit të aftësive profesionale.
4. Menaxhimi i rasteve dhe mbështetja e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijës (NjMF) në bashki, Punonjësve të Mbrojtjes së fëmijëve në njësitë administrative, për të garantuar parandalimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e fëmijëve të rrezikuar dhe prekur nga abuzimi, dhuna, neglizhimi, shfrytëzimi, trafikimi dhe në konflikt me ligjin, në përputhje me planin individual të ndërhyrjes për fëmijën dhe procesin ndërsektorial të menaxhimit të rastit.
5. Parandalimi i abuzimit të fëmijëve, shfrytëzimit, trafikimit apo ekspozimit ndaj migracionit të pasigurtë si dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve, vlerave kulturore e sociale.
6. Modelimi, ngritja e Njesisë për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimin (NjVNR) dhe forcimi i kapaciteteve teknike të stafit për ofrimin e shërbimeve lidhur me vlerësimin e nevojave dhe referimin, për migrantët e kthyer dhe personat në rrezik të migrimit të pasigurt, si dhe grupe të tjera vulnerabël në komunitet, me fokus të veçantë në njësitë administrative.
7. Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve të ofruesve të shërbimeve dhe disiplinave të ndryshme, si dhe menaxherëve të tyre për të ofruar dhe menaxhuar shërbime efektive që aksesohen dhe mbështesin fëmijët në rrezik apo vulnerabël si dhe për të përmirësuar mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve.
8. Nxitja e bashkëpunimit dhe koordinimit midis komuniteteve, organizatave të shoqërisë civile, dhe institucioneve të bashkisë, në mënyrë që të mundësojë riintegrimin e plotë të fëmijëve dhe familjeve vulnerabël të kthyer nga migracioni, fëmijëve dhe familjeve në rrezik trafikimi dhe familjeve të prekura nga pandemia COVID-19.
9. Zbatimin e një modeli të shërbimeve dhe protokollit të punës për riintegrimin e fëmijëve në konflikt me ligjin.
10. Planifikimi efektiv i shërbimeve sociale vendore në kuadër të reformës së decentralizimit.

NENI 5

Angazhimet e palëve

5.1 Bashkia merr përsipër



1. Të promovojë të drejtat e fëmijëve në përputhje me legjislacionin në fuqi, strategjitë përkatëse dhe standartet e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe ato të mbrojtjes së fëmijëve.
2. Të planifikojë shërbimet e kujdesit shoqëror në Bashkinë Shkodër, në mënyrë të koordinuar me aktorët relevant dhe me pjesëmarrje të komunitetit, si dhe të planifikojë brenda buxhetit të bashkisë, buxhetin për shërbimet e kujdesit shoqëror, duke parashikuar një linjë të vecantë për fëmijët në nevojë për mbrojtje/situatë emergjente dhe shërbimet ndaj tyre.
3. Të identifikojë, referojë, planifikojë dhe ndjekë në mënyrë proaktive rastet e familjeve, fëmijëve apo të rinjve në nevojë për mbështetje me shërbime sociale, me shërbime të mbrojtjes, me fuqizim socio-ekonomik apo me përfshirje në ndërhyrje parandaluese si dhe koordinimin e tyre me aktorët e tjerë të zonës që ofrojnë shërbime për mbështetje specifike.
4. Të angazhohet në zhvillimin dhe mbështetjen e shërbimeve me bazë komunitare pranë qendrave komunitare “Për Familjen” nr. 2 dhe nr. 5 të Bashkisë përmes pajisjes me staf të kualifikuar dhe burimet e nevojshme për funksionimin në vazhdimësi të shërbimit, si edhe zbatimit të modelit të ofruar nga Tdh.
5. Të mundësojë që stafi i qendrave komunitare “Për Familjen” të trajnohet për ofrimin e shërbimeve komunitare, të marrë pjesë në mënyrë të rregullt në një proces mentorimi dhe mbështetjeje të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve përgjatë punës, të mundësojë punën në komunitet të stafit për identifikimin dhe ndjekjen e rasteve.
6. Të sigurojë pjesëmarrjen e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shendetit Publik, Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijëve në bashki dhe në njësitë administrative, të punonjësve socialë ofrues të shërbimeve të bashkisë në punën koordinuese dhe atë në terren për identifikimin e hershëm të fëmijëve, të rinjve dhe familjeve vulnerabël të rikthyer apo në rrezik për migrim të pasigurtë, fëmijëve dhe familjeve vulnerabël në rrezik trafikimi, fëmijëve dhe familjeve vulnerabël të prekur nga pandemia e COVID-19 si dhe fëmijët/të rinjtë në konflikt me ligjin për referimin e tyre në shërbime relevante të zonës.
7. Të sigurojë pjesëmarrjen e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shendetit Publik si dhe Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijëve në bashki dhe në njësitë administrative, të punonjësve socialë ofrues të shërbimeve të bashkisë në trajnimet që do të organizohen për ngritjen e kapaciteteve profesionale.
8. Të aplikojë mbledhjen e të dhënave të rridhura me menaxhimin e rastit dhe shërbimeve të ofruara për to duke garantuar mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave, duke marrë masa paraprake



që të dhënat të mblidhen dhe ruhen sistematikisht edhe në forma të tjera përveç sistemit database.

9. Të marrë pjesë në mënyrë të rregullt në takimet periodike për rishikimin e planeve dhe ecurinë e punës të projekteve të mbështetura financiarisht nga GIZ, Bashkimi Europian dhe Unicef-UK në qytetin e Shkodrës, të koordinuara nga Terre des hommes.
10. Të përcaktojë një punonjës nga Bashkia, i cili do të angazhohet drejtpërdrejtë dhe do të jetë si pikë kontakti në komunikimet ndërmjet palëve për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.
11. Të sigurojë koordinimin dhe komunikimin mbi këtë marrëveshje midis drejtorive të bashkisë dhe institucionet në varësi të saj, me anë të pikës së kontaktit.
12. Të udhëheqë bashkëpunimet me aktorë relevant të shoqërisë civile, sektorit privat dhe atij publik në drejtim të përmirësimit të kushteve të jetesës të grupeve vulnerabël.

5.2 Tdh merr përsipër:

1. Të ofrojë asistencë teknike për planifikimin efektiv të shërbimeve shoqërore me Bashkinë Shkodër.
2. Të zhvillojë shërbimet komunitare në qendrën komunitare “Për Familjen” nr. 2 dhe nr. 5 të bashkisë me fokus fëmijët dhe familjet vulnerabël me elemente kryesore menaxhimin e rastit dhe ofrimin e shërbimeve të fuqizimit të familjes, shërbime për përmirësimin e situatës ekonomike, këshillim psiko-social individual apo në grup; shërbimet e mbrojtjes; mobilizmin komunitar; mbështetjen edukative dhe zhvillimore të fëmijëve dhe të rinjve, programin e prindërimit, angazhimin e vullnetarëve etj.
3. Të mbështesë aktivitetet për gjenerimin e të ardhurave për familjet e fëmijëve vulnerabël në mënyrë që të kenë mundësitë minimale për të siguruar mirëqënien e fëmijëve apo mbrojtjen e tyre nga shfrytëzimi për punë, migracioni i pasigurtë.
4. Të mbështesë individët vulnerabël dhe ata të rikthyer nëpërmjet formimit të paguar në vendin e punës dhe kurseve profesionale, në mënyrë që të zhvillojnë aftësi profesionale dhe të punësohen për të përmirësuar gjendjen ekonomike të tyre.
5. Të mbështesë një program prindërimi në bashkëpunim me shërbimet sociale në komunitet me fokus informimin mbi tema për prindërimin pozitiv dhe ngritjen e grupeve të mbështetjes së njëri-tjetrit.



6. Të mundësojë aktivitete të rregullta psikosociale nga animatorë të trajnuar për të lehtësuar integrimin e fëmijëve vulnerabël në shkollë dhe komunitet duke rritur aftësitë e tyre të reziliencës dhe aftësitë për jetën.
7. Të mundësojë klasat për mbështetje mësimore të fëmijëve dhe të rinjve më vulnerabël për të mundësuar riintegrimin e tyre në sistemin arsimor dhe për të reduktuar stigmën dhe përjashtimin e fëmijëve të rikthyer nga migracioni.
8. Të mbështesë grupet komunitare të të rriturve, të edukatorëve bashkëmoshatar të fëmijëve dhe të rinjve, në aktivitetet ndërgjegjësuëse që ato përzgjedhin dhe funksionimin e tyre efektiv, duke u trajnuar dhe informuar mbi mobilizimin e këtyre grupeve, lidhshpimit, duke zhvilluar aftësitë për jetën dhe aftësitë për organizimin e nismave dhe aktiviteteve për ndryshim social.
9. Të mbështesë me ndihmë direkte familjet vulnerabël të prekur nga pandemia e COVID-19 në mënyrë që të kenë mundësitë minimale për të siguruar mirëqënien e fëmijëve apo mbrojtjen e tyre.
10. Të realizojë ngritjen e kapaciteteve për profesionistët që punojnë në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror për familjet vulnerabël, përfshirë ato për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, shfrytëzimi, në konflikt me ligjin, trafikim apo migracioni i pasigurtë si dhe stafin e njësive administrative përmes trajnimeve formale dhe mbështetjes së profesionistëve përgjatë punës me anë të mentorimit gjysëm të strukturuar ose asistences teknike përgjatë punës.
11. Të mbështesë Bashkinë për modelimin dhe ngritjen e Njesisë për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimin (NjVNR), dhe të forcojë kapacitetet e tyre teknike për ofrimin e shërbimeve lidhur me vlerësimin e nevojave dhe referimin, për migrantët e kthyer dhe personat në rrezik të migrimit të pasigurt, si dhe grupe të tjera të vulnerabël në komunitet, me fokus të veçantë në njësitë administrative.
12. Të mbështesë Bashkinë në planifikimin dhe realizimin e aktivitete të vazhdueshme për promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe parandalimin e abuzimit të fëmijëve, shfrytëzimit, trafikimit apo ekspozimit në migracion të pasigurtë.
13. Të përcaktojë një punonjës nga organizata Tdh, i cili do të angazhohet drejtëpërdrejtë dhe do të jetë si pikë kontakti në komunikimet ndërmjet palëve për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.



NENI 6

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë 2 vjeçare duke filluar nga dita e nënshkrimit të saj dhe do të jetë efektive përgjatë këtij afati.
2. Rishikimi i mëtejshëm do të jetë objekt i diskutimit të palëve të Marrëveshjes.

NENI 7

Zbatimi i marrëveshjes

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje, për të qenë partnere në koordinimin e të gjitha veprimeve dhe nismave që do të garantojnë përmbushjen dhe realizimin me sukses të saj.

NENI 8

Përfundimi i Marrëveshjes

1. Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje në rastet kur:
 - a. mbaron afati i kohëzgjatjes i përcaktuar në marrëveshje
 - b. shkelen dispozitat e ligjit dhe të marrëveshjes,
 - c. palët nuk i përmbahen qëllimit dhe objektit të marrëveshjes .
2. Secila nga palët duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të marrëdhënieve të Marrëveshjes, duke dhënë sqarime të hollësishme dhe të qëndrueshme mbi këtë ndërprerje.
3. Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

NENI 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen nëpërmjet negocimit dhe me mirëkuptim.

NENI 10



Dispozita të fundit

1. Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve të kësaj Marrëveshje, për të qenë partnere në zbatimin e saj duke punuar për realizimin e veprimtarive të përbashkëta.
2. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dy palët.

NENI 11

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe do të vijojë të zbatohet për një periudhë 2 vjeçare.
2. Kjo Marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje, nga 2 (dy) kopje për secilën palë, të cilët pasi bien dakord e nënshkruajnë atë rregullisht.

**PËR
BASHKINË SHKODËR**

KRYETAR

Znj. Voltana Ademi



**PËR
TERRE DES HOMMES, MISSIONI NË
SHQIPËRI**

DREJTORE PËR SHQIPËRINË

Znj. Enkelejda Kallçiu

